

آداب السفر وأحكامه (للجمعية)

**Normat dhe dispozitat e
udhëtimit**

Normat dhe dispozitat e udhëtimit

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve, paqja e bekimi qofshin mbi Profetin tonë Muhamedin, familjen dhe mbarë shokët e tij.

Sakaq...

Kjo është një broshurë e shkurtër mbi normat dhe dispozitat e udhëtimit, ku jemi munduar të përmbledhim çështjet më të rëndësishme që i nevojiten udhëtarit.

Lusim Allahun që ta bëjë këtë vepër të sinqertë për fytyrën e Tij fisnike dhe të dobishme për të gjithë myslimanët.

Komisioni shkencor pranë Qendrës për Shërbimin e Mesazhit Islam në Gjuhë të Ndryshme

Së pari: Normat e udhëtimit

Është e rekomandueshme që ai që niset për Haxh apo për ndonjë adhurim tjetër të kujdeset për këto çështje:

1.Të kërkojë mirësi (istihare) nga Allahu në lidhje me kohën e udhëtimit, mjetin e transportit, shokun e udhëtimit dhe drejtimin, nëse ka më shumë se një rrugë. Po ashtu, të konsultohet me njerëz që kanë përvojë dhe janë të devotshëm. Sa i takon Haxhit dhe Umres ato janë mirësi pa asnjë dyshim. Forma e istihares (e kërimit të mirësisë) është që të falë dy rekate dhe të lutet me lutjen e transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të!).

2. Haxhiu dhe ai që shkon për Umre duhet të synojë vetëm kënaqësinë e Allahut me këtë adhurim dhe afrimitetin ndaj Tij. Duhet të ruhet nga synimi i përfitimeve materiale, mburrja, dëshira për tituj apo reputacion para të tjerëve, sepse këto janë shkaqe që çojnë në prishjen e veprës dhe mospranimin e saj. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهٌ وَحْدٌ فَمَن كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾

“Thuaj: “Unë jam vetëm një njeri (vdekatar) si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” (El-Kehf: 110) Në një hadith kudsij thuhet:

«أَنَا أَعْنَى الشِّرْكَاءِ عَنِ الشِّرْكِ، مَنْ عَمِلَ عَمَلًا أَشْرَكَ فِيهِ مَعِيَ غَيْرِي تَرَكْنَاهُ وَشِرْكُهُ» [1].

"Unë jam më i pavaruri nga ortakët në ortakëri. Kush bën një vepër duke bërë dikë pjesëtar me Mua, unë e braktis atë dhe ortakërinë e tij." (1)¹

3. Haxhiu dhe ai që shkon për Umre duhet të mësojë dispozitat e Umres, Haxhit dhe udhëtimit para se të niset, që të mos lërë ndonjë detyrim pa bërë apo të mos përfshihet në ndonjë ndalesë. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ يُرِدِ اللَّهُ بِهِ خَيْرًا يُفَقِّهْهُ فِي الدِّينِ» [2].

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2985.

"Kujt ia do Allahu të mirën, e bën të kuptojë fenë."(2)¹

4. Haxhiu ose umrexhiu duhet të sigurohet që shpenzimet për Haxh dhe Umre të jenë nga pasuri e lejuar (hallall), sepse Allahu është i pastër dhe pranon vetëm të pastërtën. Dhe ngase pasuria e ndaluar është shkak për mospranimin e lutjeve.

5. Të pendohet për të gjitha mëkatet dhe nëse i ka bërë dikujt padrejtësi ose i ka hyrë në hak, t'ia kthejë hakun e t'i kërkojë falje qoftë në çështje nderi, pasurie apo të tjera.

6. Është e pëlqyeshme që udhëtari të shkruajë testamentin e tij, të sqarojë se çfarë i detyrohen të tjerët dhe çfarë u detyrohet ai atyre. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَا حَقُّ أَمْرِي مُسْلِمٍ لَهُ شَيْءٌ يُوصِي فِيهِ بَيِّتٌ لِبَلَّتَيْنِ إِلَّا وَصِيَّتُهُ مَكْتُوبَةٌ عِنْدَهُ» [3]

"Nuk i takon një muslimani që ka diçka për të lënë amanet, të flejë dy net pa pasur testamentin e tij të shkruar pranë tij."(3)² Të vërë dëshmitarë mbi këtë testament, të shlyejë borxhet që ka dhe të kthejë amanetet, ose të marrë leje nga pronarët për t'i mbajtur.

7. Është e rekomandueshme që udhëtari të përpiqet të zgjedhë shok të mirë udhëtimi, dhe të bëjë çmos që të jetë dikush nga nxënësit e dijes

¹ Transmetuan Buhariu nr. 2738 dhe Muslimi nr. 1627.

² Transmetoi Ebu Daudi nr. 4833.

fetare, sepse kjo është prej shkaqeve të mbarëvajtjes dhe shmangies së gabimeve gjatë udhëtimit, Haxhit dhe Umres. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«الرَّجُلُ عَلَى دِينِ خَلِيلِهِ، فَلْيَنْظُرْ أَحَدُكُمْ مَنْ يُخَالِلُ» [4]؛

"Njeriu është në fenë e mikut të tij, ndaj secili prej jush të shohë me kë miqësohet." (4)¹ Dhe bazuar në fjalën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të!):

«لَا تُصَاحِبْ إِلَّا مُؤْمِنًا، وَلَا يَأْكُلْ طَعَامُكَ إِلَّا تَقِيٌّ» [5].

"Mos shoqëro askënd përveçse besimtarin, dhe mos ta hajë ushqimin tënd përveçse i devotshmi." (5)²

8. Preferohet që udhëtari të përshëndetet me familjen, të afërmit, fqinjët dhe shokët e tij para udhëtimit. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«مَنْ أَرَادَ أَنْ يُسَافِرَ فَلْيَقُلْ لِمَنْ يُخَلْفُ: أَسْتَوِدِعُكُمْ اللَّهَ الَّذِي لَا يُضِيعُ وَدَائِعَهُ» [6]،

"Ai që dëshiron të udhëtojë le t'i thotë atyre që lë pas: Ju lë në amanetin e Allahut, amanetet e të Cilit nuk humbin." (6)³ Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) i përshëndeste shokët e tij kur dikush prej tyre nisej për udhëtim dhe thoshte:

«أَسْتَوِدِعُ اللَّهَ دِينَكَ وَأَمَانَتَكَ وَخَوَاتِيمَ عَمَلِكَ» [7]،

¹ Transmetuan Ebu Daudi nr. 4832 dhe Tirmidhiu nr. 2395.

² Transmetoi Tabrani nr. 823.

³ Transmetoi Ahmedin në Musnedin e tij nr. 4524.

"E lë në kujdesin e Allahut fenë tënde, amanetin tënd dhe përfundimin e veprave të tua."(7)¹ Po ashtu, ai (paqja qoftë mbi të!) i thoshte atij që i kërkonte këshillë për udhëtim:

«رَوَدَكَ اللَّهُ النَّفْوَى، وَغَفَرَ ذَنْبَكَ، وَيَسَّرَ لَكَ الْخَيْرَ حَيْثُ مَا كُنْتَ» [8]

"Allahu të furnizoftë me devotshmëri, të faltë mëkatet dhe të lehtësoftë të mirat, kudo që të jesh."(8)² Një burrë erdhi tek i Dërguari (paqja qoftë mbi të!) për t'u nisur në udhëtim dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut, më këshillo!" Ai tha:

«أَوْصِيكَ بِتَقْوَى اللَّهِ، وَالتَّكْبِيرِ عَلَى كُلِّ شَرَفٍ» فَلَمَّا مَضَى قَالَ: «اللَّهُمَّ ارْزُ لَهُ الْأَرْضَ، وَهَوِّنْ عَلَيْهِ السَّفَرَ» [9].

"Të këshilloj të kesh frikë nga Allahu dhe të bësh tekbir sa herë që të ngjitesh në një vend të lartë." Pasi u nis, Profeti tha: (O Allah, tkurre për të tokën (shkurtoja udhëtimin) dhe lehtësoja udhëtimin."(9)³

9. Nuk duhet të marrë me vete në udhëtim këmborë, fyell apo qen, për shkak të hadithit të Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ku Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَا تَصْحَبِ الْمَلَانِكَةَ رُقْفَةً فِيهَا كَلْبٌ وَلَا جَرَسٌ» [10].

"Melekët nuk e shoqërojnë atë grup të njerëzve që kanë qen apo këmborë."(10)⁴

¹ Transmetoi Tirmidhiu nr. 3444.

² Transmetoi Ahmed i në Musnedin e tij nr. 9724.

³ Transmetoi Muslimi nr. 2113.

⁴ Transmetuan Buhariu nr. 2593 dhe Muslimi nr. 2770.

10. Nëse dikush ka më shumë se një bashkëshorte dhe dëshiron të udhëtojë me njërin prej tyre, duhet të hedhë short mes tyre, ajo që bie në short, udhëton me të. Sipas hadithit të Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!):

«كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: إِذَا أَرَادَ سَفَرًا أَفْرَعَ بَيْنَ نِسَائِهِ، فَأَيُّهُنَّ خَرَجَ سَهْمُهَا خَرَجَ بِهَا مَعَهُ» [11].

"I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!), kur dëshironte të udhëtonte, hidhte short mes grave të tij. Asaj që i binte shorti, udhëtonte me të." (11)¹

11. Është e pëlqyer që të niset për udhëtim ditën e enjte në mëngjes, nëse ka mundësi, sipas veprimt të Profetit (paqja qoftë mbi të!). Ka'b ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

«لَقَدْ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَخْرُجُ إِذَا خَرَجَ فِي سَفَرٍ إِلَّا يَوْمَ الْخَمِيسِ» [12].

"Rrallëherë ndodhte që i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) të nisej në udhëtim, përveçse në ditën e enjte." (12)²

12. Pëlqehet që kur të dalë nga shtëpia të thotë lutjen e daljes nga shtëpia kur niset për udhëtim ose kur del për arsye tjera:

«بِسْمِ اللَّهِ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَضِلَّ أَوْ أُضَلَّ، أَوْ أَزِلَّ أَوْ أُزَلَ، أَوْ أَظْلِمَ أَوْ أُظْلِمَ، أَوْ أَجْهَلَ أَوْ يُجْهَلَ عَلَيَّ» [13].

"Bismil-lahi teuek-keltu alellahi ue la haule ue la kuvvete il-la bil-lahi, Allahumme inni eudhu bike en

¹ Transmetoi Buhariu nr. 2949.

² Transmetoi Ebu Daudi nr. 5094.

edil-le eu udal-le eu ezil-le eu uzal-le eu edhlime eu udhleme eu exh'hele eu juxh'hele alejje" (13):

13. Pëlqehet që të thotë lutjen e udhëtimit kur të ngjitet mbi kafshën e udhëtimit, kur të hipë në makinë dhe kur të hipë në avion ose në mjetet e tjera të transportit. Lutja është:

«اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ ثُمَّ يَقُولُ: {سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ وَإِنَّا إِلَىٰ رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ} [الزخرف: 14] اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ فِي سَفَرِنَا هَذَا الْبِرَّ وَالتَّقْوَىٰ، وَمِنَ الْعَمَلِ مَا تَرْضَىٰ، اللَّهُمَّ هَوِّنْ عَلَيْنَا السَّفَرَ، وَاطْوِ عَنَّا بُعْدَهُ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الصَّاحِبُ فِي السَّفَرِ، وَالْخَلِيفَةُ فِي الْأَهْلِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ وَعْثَاءِ [14] السَّفَرِ، وَكَآبَةِ الْمَنْظَرِ [15]، وَسَوْءِ الْمُنْقَلَبِ [16] فِي الْمَالِ وَالْأَهْلِ..» [17].

"Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber. Subhanel-ledhi sekbara lena hadha ue ma kunna lehu mukrinine ue inna ila rabbina lemunkalibun" (Zuhurf:14) Allahumme inna nes'eluke fi seferina hadha el birre uet tek'ua ue minel ameli ma terda. Allahumme hevvin alejna es-sefera uet'ui anna bu'dehu. Allahume entes-sahibu fis-seferi uel halifetu fil ehli. Allahumme inni eudhu bike min ua'thais-seferi(14) ue keabetil mendhari(15) ue suil munkalebi(16) fil mali uel ehl..."(17)

Përkthimi: (Allahu është më i madhi! (3 herë) I Lartmadhëruar qoftë Ai që nënshtroi këtë për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë. Ne, me të vërtetë tek Zoti ynë do të kthehemi. O Zoti

¹ Vështirësitë dhe vuajtjet e udhëtimit. Shiko "El Ifsah an Meanis-Sihah (4/284).

ynë, të lutemi që në udhëtimin tonë të na mundësosh të bëjmë mirësi dhe të jemi të devotshëm, të bëjmë vepra me të cilat Ti je i kënaqur. O Zoti ynë, na e lehtëso neve udhëtimin tonë dhe na e bëj të rehatshme rrugën. O Zoti ynë, Ti je shoqërues në udhëtim dhe mbrojtës i familjes sonë në mungesën tonë. O Zoti im, kërkoj që të më mbrosh nga vështirësitë e udhëtimit, nga pamja e mjeruar dhe nga telashet në pasuri dhe familje).¹²³⁴

14. Pëlqehet që të mos udhëtojë i vetëm pa shokë, ngase Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«لَوْ يَعْلَمُ النَّاسُ مَا فِي الْوَحْدَةِ مَا أَعْلَمَ مَا سَارَ رَاكِبٌ بِلَيْلٍ وَحْدَهُ» [18]

"Sikur njerëzit ta dinin çfarë fshihet në vetminë, askush nuk do të udhëtonte vetëm natën." (18)⁵

15. Udhëtarët duhet të caktojnë një udhëheqës nga mesi i tyre, sepse kjo bën të mundur unitetin, bashkimin dhe realizimin e qëllimeve të tyre. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«إِذَا خَرَجَ ثَلَاثَةٌ فِي سَفَرٍ فَلْيُؤَمِّرُوا أَحَدَهُمْ» [19]

"Kur tre vetë nisen për të udhëtuar, le ta caktojnë njërin prej tyre udhëheqës." (19)⁶

¹ Transmetoi Buhariu nr. 2998.

² Transmetoi Ahmedî në Musnedin e tij nr. 6374.

³ Kthimi me telashe te familja dhe prona. Shiko "El-Ihsan an Meanis-Sihah (4/284),

⁴ Pamje e trishtë dhe e mjeruar nga pikëllimi. Shiko "El Ihsan an Meanis-Sihah (4/284)

⁵ Transmetoi Ebu Daudi nr. 2608.

⁶ Transmetoi Ahmedî në Musnedin e tij nr. 17736.

16. Të jetë i kujdesshëm në përmbushjen e detyrimeve fetare dhe në shmangien e ndalesave, të ketë sjellje të larta, të ndihmojë nevojtarët, t'i japë dije atij që ia kërkon dhe ka nevojë për të, dhe të jetë bujar me pasurinë e tij për veten dhe për nevojat e shokëve të tij.

17. Të shpenzojë më tepër për nevojat e udhëtimit, sepse mund të dalin nevoja të ndryshme gjatë udhëtimit dhe rrethanat mund të ndryshojnë.

18. Të jetë i buzëqeshur, i lumtur, dhe i përkushtuar në gëzimin e bashkëudhëtarëve, që të bëhet i dashur dhe miqësor me ta.

19. Të ketë durim nëse ndonjëri prej bashkëudhëtarëve tregohet i vrazhdë, ose nuk bie dakord me mendimin e tij. Të sillet me ta me butësi e durim, në mënyrë që të gëzojë autoritet dhe respekt.

20. Është e rekomanduar që kur udhëtarët të ndalen për pushim, të qëndrojnë pranë njëri-tjetrit. Disa prej shokëve të Profetit (paqja qoftë mbi të!) kur ndaleshin, shpërndareshin nëpër lugina e kodra. Profeti (paqja qoftë mbi të!) tha:

«إِنَّ تَفَرُّقَكُمْ فِي الشَّعَابِ وَالْأَوْدِيَةِ إِنَّمَا ذَلِكُمْ مِنَ الشَّيْطَانِ» [20]

"Shpërndarja juaj nëpër grykat e maleve dhe nëpër lugina është prej shejtanit." (20)¹ Pas kësaj, ata qëndronin të bashkuar, deri në atë masë sa nëse hidhej mbi ta një pëlhurë, i mbulonte.

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2708.

21. Rekomandohet që kur ndalon në një vend gjatë udhëtimit ose jashtë tij, të thotë lutjen që përcillet nga Profeti (paqja qoftë mbi të!):

«أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ» [21]؛

"E'ūdhu bi kelimātil-lāhit-tāmmāti min sherri mā ḥaleka!" (Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut prej së keqes së çdo gjëje që Ai ka krijuar!) (21)¹ Nëse e thotë këtë nuk i ndodh gjë e keqe, derisa të largohet nga ai vend.

22. Pëlqehet të thotë "Allahu ekber" saherë që ngjitet në vende të larta, dhe të thotë "Subhanallah" saherë që zbret në ultësira apo lugina. Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Kur ngjiteshim, thonim "Allahu ekber", e kur zbrisnim, thonim "subhanallah." (22)² Por, pa e ngritur zërin në mënyrë të tepruar, sepse Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«يَا أَيُّهَا النَّاسُ ارْبَعُوا عَلَى أَنْفُسِكُمْ فَإِنَّكُم لَا تَدْعُونَ أَصَمًّا وَلَا غَائِبًا إِنَّهُ مَعَكُمْ إِنَّهُ سَمِيعٌ قَرِيبٌ» [23].

"O njerëz, qetësohuni, sepse nuk po i luteni një të shurdhëri apo një të largëti. Ai është me ju, Ai është Dëgjues dhe i Afërt." (23)³

23. Është e pëlqyer të udhëtohet natën, veçanërisht në pjesën e fundit të saj, sepse Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

¹ Transmetoi Buhariu nr. 2994.

² Transmetoi Buhariu nr. 2993.

³ Transmetoi Ebu Daudi nr. 2571.

«عَلَيْكُمْ بِالذُّلْجَةِ؛ فَإِنَّ الْأَرْضَ تُطْوَى بِاللَّيْلِ» [24].

"Udhëtoni në pjesën e fundit të natës, sepse natën toka tkurret (shkurtohet udhëtimi)." (24)¹

24. Është e pëlqyer të bëjë sa më shumë lutje gjatë udhëtimit, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«ثَلَاثُ دَعَوَاتٍ مُسْتَجَابَاتٌ لَا شَكَّ فِيهِنَّ: دَعْوَةُ الْمَظْلُومِ، وَدَعْوَةُ الْمُسَافِرِ، وَدَعْوَةُ الْوَالِدِ عَلَى وَلَدِهِ» [25].

"Tri lutje pranohen pa dyshim: lutja e të shtypurit, lutja e udhëtarit dhe lutja e prindit për fëmijën e tij." (25)²

Së dyti: Pastërtia (higjena) gjatë udhëtimit

Udhëtari duhet të kujdeset për pastërtinë: të marrë abdes për ndotjen e vogël (prishja e abdesit) dhe të lahet nga ndotja e madhe (xhynybllëku).

Nëse nuk gjen ujë, ose ka vetëm pak ujë që i nevojitet për të gatuar dhe për të pirë, atëherë bën tejemum.

Mënyra e tejemumit është si vijon:

Të godasë tokën me duart e tij, pastaj t'i fërkojë me to fytyrën dhe pëllëmbët.

Pastrimi me tejemum është pastrim i përkohshëm; sapo të gjendet uji, ai bëhet i pavlefshëm dhe është i detyrueshëm përdorimi i ujit. Nëse dikush ka bërë tejemum për shkak të

¹ Transmetoi Ahmedî në Musnedin e tij nr. 10771.

² Transmetoi Bezzari në Musnedin e tij nr. 10068.

xhynybllekut, e më pas gjen ujë, e ka për detyrë që të lahet. Dhe nëse ka bërë tejemum pas daljes nga nevojtorja, e më pas gjen ujë, e ka për detyrë që të marrë abdes. Në hadith thuhet:

«الصَّعِيدُ الطَّيِّبُ وَضُوءُ الْمُسْلِمِ وَإِنْ لَمْ يَجِدِ الْمَاءَ عَشْرَ سِنِينَ، فَإِذَا وَجَدَ الْمَاءَ فَلْيَتَوَضَّعْ لِلَّهِ، وَلْيُمِسَّهُ بِشَرَّتِهِ» [26].

“Dheu i pastër është abdesi i muslimanit, edhe nëse nuk gjen ujë për dhjetë vjet, por kur ta gjejë ujin, le ta ketë frikë Allahun dhe ta përdorë atë për të pastruar trupin e tij.”(26)¹

Fshirja (dhënia e mes'hut) mbi mestet është e ligjësuar me tekstin e Kuranit, Sunetin dhe konsensusin e Ehli Sunetit.

Këto janë kushtet për fshirjen (dhënien e mes'hut) mbi mestet apo çfarëdo që merr gjykimin e tyre:

1. Mestet ose çorapet të jenë të lejuara (material i lejuar) dhe të pastra.

2. T'i ketë veshur ato duke qenë i pastër (me abdes).

3. Të mbulojnë pjesën që është e detyrueshme të lahet gjatë abdesit.

4. Fshirja (dhënia e mes'hut) lejohet vetëm për ndotjen e vogël, (pra kur është prishur abdesi), jo për xhynybllekun apo për diçka tjetër që e bën të detyrueshme larjen e plotë të trupit.

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1804 dhe Muslimi nr. 1927.

5. Fshirja (dhënia e mes'hut) lejohet vetëm brenda kohës së caktuar nga Sheriati: një ditë e një natë për banuesin (rezidentin) dhe tre ditë e netë për udhëtarin. Sipas mendimit më të saktë, kjo periudhë fillon nga momenti i parë që fshin mbi mestet pas ndotjes (prishjes së abdesit) dhe zgjat 24 orë për banuesin (rezidentin) dhe 72 orë për udhëtarin.

Fshirja (dhënia e mes'hut) mbi mestet priset në tri raste:

1. Nëse ndodh diçka që e bën të detyrueshme larjen si xhynybllëku, fshirja (mes'hu) bëhet e pavlefshme dhe duhet larë medoemos.

2. Nëse i heq mestet pasi i ka dhënë mes'h.

3. Nëse përfundon koha e lejuar nga Sheriati për dhënien e mes'hut, atëherë mes'hu priset.

Së treti: Dispozitat e shkurtimit të namazit gjatë udhëtimit:

Shkurtimi i namazit gjatë udhëtimit është më i preferuar se sa falja e plotë, por nëse udhëtari e fal namazin katërrekatësh të plotë (katër rekate), atëherë namazi i tij është i saktë, por ai ka vepruar në kundërshtim me më të mirën.

Udhëtari fillon ta shkurtojë namazin kur del jashtë të gjitha shtëpive të fshatit ose qytetit të tij. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Nëse udhëtari niset për udhëtim pasi të ketë hyrë koha e namazit, ai ka të drejtë ta shkurtojë atë, sepse udhëtimin e ka nisur para se të dalë koha e namazit.

Sa i përket bashkimit të namazit të drekës me ikindinë dhe të akshamit me jacinë, ky është një Sunet për udhëtarin kur ka nevojë për të, nëse është në lëvizje dhe udhëtimi po vazhdon. Atëherë ai vepron sipas asaj që është më e lehtë për të, ose e përshpejton bashkimin ose e shtyn.

Nëse udhëtari nuk ka nevojë për bashkimin e namazeve, atëherë nuk i bashkon, si p.sh. kur është ndalur në një vend dhe nuk ka ndërmend të niset, derisa të hyjë koha e namazit të dytë. Në këtë rast, më e preferuara është të mos i bashkojë, sepse nuk ka nevojë për këtë. Për këtë arsye, Profeti (paqja qoftë mbi të) nuk i bashkoi namazet kur ishte ndalur në Mina gjatë Haxhit të Lamtumirës, sepse nuk kishte nevojë për t'i bashkuar.

Sa i përket namazeve vullnetare, udhëtari mund të falë siç fal rezidenti, si namazin e duhasë, namazin e natës, vitrin dhe namaze të tjera nafile, përveç suneteve të rregullta të drekës, akshamit dhe jadisë, për to Suneti është që të mos falen gjatë udhëtimit.

Është e lejuar falja e namazeve vullnetare gjatë udhëtimit në mjetin e transportit si aeroplan, makinë, anije apo të tjera. Ndërsa për farzin, duhet

të zbresë dhe ta falë në tokë, përveçse kur nuk ka mundësi.

Nëse udhëtari falet pas një banori rezident, namazi i tij është i vlefshëm, dhe ai duhet të plotësojë (katër rekate), njësoj si imami i tij, pa përjashtim nëse e ka zënë tërë namazin me të, apo vetëm një rekat, apo edhe më pak. Edhe nëse hyn me të vetëm në teshehudin e fundit para selamit, ai e plotëson namazin. Ky është mendimi më i saktë nga dy mendimet e dijetarëve.

Së katërti: Normat e kthimit nga Haxhi, Umreja apo udhëtimi

Udhëtari duhet të nxitojë të kthehet dhe të mos e zgjasë qëndrimin në udhëtim pa nevojë, për shkak të fjalës së Profetit (paqja qoftë mbi të!):

«السَّفَرُ قِطْعَةٌ مِنَ الْعَذَابِ، يَمْنَعُ أَحَدَكُمْ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ وَتَوَمُّهُ، فَإِذَا قَضَى نَهْمَتَهُ فَلْيُعِجِّلْ إِلَى أَهْلِهِ» [27].

“Udhëtimi është një pjesë e vuajtjes; e pengon njërin prej jush nga ushqimi, pija dhe gjumi, prandaj kur ndonjëri nga ju e përmbush nevojën e vet, le të nxitojë të kthehet te familja e tij.” (27)¹

Kur të vendosë të kthehet në vendin e tij, le të lexojë lutjen e udhëtimit, kur hipën në mjetin e tij dhe të shtojë:

«أَيُّوْنَ تَائِبُونَ عَابِدُونَ لِرَبِّنَا حَامِدُونَ» [28].

¹ Transmetuan Buhariu nr. 1797 dhe Muslimi nr. 1342.

"Aibune, taibune, abidune li-Rabbina hamidune"(28)¹

Pëlqehet që gjatë kthimit nga udhëtimi të thotë lutjen që thoshte Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) kur kthehej nga ekspedita, Haxhi ose Umreja pasi bente tekbir tri herë, saherë që ngjitej mbi një kodër thoshte:

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ،
أَيُّوبُ، ثَائِبُونَ، عَابِدُونَ، سَاجِدُونَ، لِرَبِّنَا حَامِدُونَ، صَدَقَ اللَّهُ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ
عَبْدَهُ، وَهَرَمَ الْأَحْرَابَ وَحْدَهُ» [29].

"La ilahe il-lellahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul-li shej'in kadir. Aibune taibune abidune saxhidune lirabbina hamidune. Sadekallahu ua'deh ue nesara abdeh ue hezemel ahzabe uahdeh"(29)

Përkthimi: "Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut, Ai është i vetëm dhe nuk ka ortak, Atij i përket sundimi dhe Atij i takon lavdia. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Po kthehemi të penduar, adhurues, sexhdebërës dhe falënderues ndaj Zotit tonë. Allahu e përmbushi premtimin, e ndihmoi robin e Tij dhe i shpartalloi palët armike i vetëm."(29)²

Kur të shohë qytetin e tij është e pëlqyeshme të thotë:

«أَيُّوبُ ثَائِبُونَ عَابِدُونَ لِرَبِّنَا حَامِدُونَ» [30].

¹ Transmetoi Buhariu nr. 4116.

² Transmetuan Buhariu nr. 1797 dhe Muslimi nr. 1342.

"Aibune taibune abidune, li Rabbina hamidune".(30)

(Po kthehemi të penduar, adhures dhe falënderues ndaj Zotit tonë)¹ Këtë e përsërit derisa të hyjë në qytetin e tij, ngase kështu ka vepruar Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!).

Nuk është mirë që të vijë natën tek familja e tij pas një mungese të gjatë, përveç nëse i ka njoftuar më parë për kohën e ardhjes. Kjo për shkak se Profeti (paqja qoftë mbi të!) e ka ndaluar një gjë të tillë. Xhabir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton:

«نَهَى رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنْ يَطْرُقَ الرَّجُلُ أَهْلَهُ لَيْلًا» [31],

"E ka ndaluar Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) që burri të kthehet te familja e tij natën."(31)² Një pjesë të urtësisë së kësaj e ka shpjeguar transmetimi tjetër ku thuhet:

«حَتَّى تَمْتَشِطَ الشَّعِثَةَ» [32], وَتَسْتَحِدَّ الْمَغِيبَةَ» [33],

"Që të krihet ajo që nuk është krehur(32) dhe të pastrohet ajo që ka qenë e vetmuar."(33)³⁴ Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

«نَهَى رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنْ يَطْرُقَ الرَّجُلُ أَهْلَهُ لَيْلًا، يَتَخَوَّنُهُمْ أَوْ يَلْتَمِسُ عَنَرَاتِهِمْ» [34].

¹ Transmetoi Muslimi nr. 715.

² "E pakrehur": ajo që nuk ka përdorur vaj flokësh dhe krehër prej kohësh. "Pastrimi i zonës intime": heqja e qimeve pubike. "E vetmuara": ajo që e ka pasur burrin larg. (Et-Tahrir fi Sherh Sahih Muslim i Asbehanit fq. 292).

³ Transmetoi Muslimi nr. 715.

⁴ Transmetoi Nesaiu nr. 9099.

“Profeti (paqja qoftë mbi të!) e ndaloi që njeriu të vijë natën tek familja e tij, duke dyshuar për tradhëti ose duke kërkuar t’i kapë në gabime.”(34)¹

Është e preferuar që udhëtari, kur kthehet nga udhëtimi, të shkojë fillimisht në xhaminë më të afërt dhe të falë dy rekate, ashtu siç vepronte Profeti (paqja qoftë mbi të!).

Është e preferuar që udhëtari, kur kthehet, të sillet mirë me fëmijët e familjes dhe të fqinjëve të tij që e presin, dhe t’i trajtojë mirë ata. Ibën Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Kur Profeti (paqja qoftë mbi të!) erdhi në Mekë, e pritën djemtë e vegjël të fisit Beni Abdulmuttalib, dhe ai mori mbi kafshën e udhëtimin njërin përpara vetes dhe tjetrin pas vetes.” Abdullah ibën Xhaferi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

“كَانَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا قَدِمَ مِنْ سَفَرٍ تَلَقَّى بَنَاءً، قَالَ: فَتَلَقَّى بِي وَبِالْحَسَنِ أَوْ بِالْحُسَيْنِ، قَالَ: فَحَمَلْتُ أَحَدَنَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَالْآخَرَ خَلْفَهُ حَتَّى دَخَلْنَا الْمَدِينَةَ” [35].

“Kur Profeti (paqja qoftë mbi të!) kthehej nga udhëtimi, na nxirrnin ta takonim. Një herë më nxorën mua dhe Hasanin ose Husejnin për ta pritur dhe ai na mori mbi devenë e tij, njërin përpara vetes dhe tjetrin prapa, derisa hymë në Medine.”(35)²

Dhurata është e rekomanduar, sepse zbut zemrat dhe largon mërinë. Është e preferuar ta pranosh dhuratën dhe të shpërblesh për të. Është e

¹ Transmetoi Muslimi nr. 2428.

² Transmetoi Bejhekiu në Sunen el-Kubra nr. 11946.

papëlqyeshme të refuzosh dhuratën pa ndonjë arsye të ligjshme. Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

«تَهَادُوا تَحَابُّوا» [36].

“Shkëmbeni dhurata, që të duheni me njëri-tjetrin.”(36)¹ Dhuratat bëjnë që të përhapet dashuria ndërmjet muslimanëve.

Kur udhëtari kthehet në vendin e tij, është e pëlqyeshme të përqafohet me njerëzit, sepse është transmetuar nga shokët e Profetit (paqja qoftë mbi të!) siç ka thënë Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!): “Kur takoheshin, përshëndeteshin me dorë, dhe kur ktheheshin nga udhëtimi, përqafoheshin.”(37)²

Salavatet dhe selamet qofshin për profetin tonë Muhamed!

¹ Transmetoi Taberani në el-Euset nr. 97.

² Transmetuan Buhariu nr. 3116 dhe Muslimi nr. 100.

Përmbajtja

Normat dhe dispozitat e udhëtimit	2
Së pari: Normat e udhëtimit	2
Së dyti: Pastërtia (higjena) gjatë udhëtimit.....	12
Së treti: Dispozitat e shkurtimit të namazit gjatë udhëtimit:	14
Së katërti: Normat e kthimit nga Haxhi, Umreja apo udhëtimi	16